

BIBLIOTEKA

S 547 F

220

FERIT
LAMAJ



fabula

2

FERIT LAMAJ



FABULA



Tiranë, 1992

TEKA E
FSH
PRIT
29 326

**Në këtë libër xhepi paraqiten disa
fabula të zgjedhura të autorit**

**Piktor:
Gëzim Tafa**

**Në kompjuter:
Lindita Shuaipi**

NJE THENIE E RE...

Që prej shekujsh rron e thëna:

"Qengj' i urtë pi dy nëna".

Por nuk dini më të renë:

"Pi servili gjithë kopenë!" ...



KUSH E HENGRI MJALTIN?

*Dëgjonin arinë
në pyll, në kuvend,
kafshë, shpendë ngrinë
rrinin si mbi gjemb.*

*-Mjaltin sot te zgjoi
kush e hëngri, kush:
sorkadhja, palloi,
a ti lepurush?*

*Pse rrini të ngratë?
Pse rrini të gjorë?
Po kur e përlatë
s'ju erdhi pak zor!?*

*Sekreti që heshtnin
na qenka gjetiu:
Me miza tek veshi
është mbushur ariu...*

SYRI DHE VESHI

Syrit na i thanë prerë:

*-Kemi pra, një vend për miq.
Mund të fillosh menjëherë,
le të merresh me muzikë!*

*Mirëpo syri me të drejtë
i shfaq tjetrit refuzimin:*

*-Dua punë që të ketë
ndopak lidhje me shikimin!*

*-S'të ndihmoj dot kurrsesi,-
i tha tjetri edhe qeshi:-*

*Atë vend që kërkon ti,
s'ka dy ditë e zuri...veshi...*

SYRI, VESHI, HUNDA

*Dhe kur sytë syze vunë,
u nxeh veshi: -Hë, moj hundë,
t'u mbush mendja që s'flas kot!
Me hile e ka kjo botë:
I mbajmë syzet unë e ti;
për të parë...sheh ai!...*



KALI E DHELPRA

Një ditë kali takon dhelpren:

-Rroftë e qoftë dinakëria!

*Me dredhira e shtyn jetën;
për këtë flet lashtësia...*

*-Do bësh mirë të kyçësh gojën
kur përmend kohën e vjetër;
kafsha që mashtroi Trojën
ishte kalë, s' ishte dhelpër!*

*-Po, vërtet ishte një kalë
që trojanët i gënjeu.
Porse ky a s' kishte dalë
nga një dhelpër, nga Odiseu!?*

IRIQI DHE KERMILLI

*Një kërmill mori një gjemb,
thirr e thirr se po i dhemb.
Jep e merr e bot e bot,
mirëpo gjëmbin s'e nxjerr dot.*

*Një iriq që nga një drizë
i thotë:- Hipmë mbi kurriz.
Më kot qahesh, kërmill ti!
Ta nxjerr unë që tani!
Andaj jemi shokë e miq...*

*-Ç'flet kështu, more iriq!?
Më nxjerr gjëmbin që më shpon,
por më ngul një batalion...*

BRESHKA DHE GOMARI

*Një breshkë ra në lumë
edhe s'po dilte dot;
u lodh e shkreta shumë,
ç'e do, nuk dinte not.*

*Kaloi andej pari,
siç thuhet në përrallë,
një kërraç, zog gomari,
që hodhi këto fjalë:*

*-Të mira ka përherë
ky lumi, more shokë!...
Tha breshka:-Byrazer,
vazhdo, se je në tokë!...*

PELLGU DHE BORA

*Një flok bore ra nga lart
te një pellg me ujë e baltë.*

*Pellgut hiç s'i erdhi mirë,
tha: -Më bëre turbullirë!*

*Ja kthen bora:-O pellg, ç'thua:
Unë ty, apo...ti mua!...*



GJUHA LLAFAZANE

*-Kjo s' durohet, -tha kurrizi
e i nxehur fort lëvizti:-*

*S'e marr vesh hiç këtë punë:
Gjuha llap, por rrihem unë!...*



MUSHKA DHE GOMARI

I thotë mushkës një gomar:

*-Kjo, për nder, s'durohet hiç;
ma hiq emrin sa më parë!*

-Mirë, po të quaj kërraç!

*Ç'u gëzua dhe veshgjati,
palli fort si asnjëherë:*

*-Të pëlcastin nga inati
kuaj, mushka e gomerë!...*


Hidhet mushka e i thotë:

*-Qysh s'e dilke, or qyqar;
ti vërtet kërraç je sot,
mot sërish bëhesh gomar!...*

TAPA DHE SHISHJA ME VAJ

*-Këtë shishe plot me vaj,-
u hodh tapa,-unë e mbaj.
Po s'qeshë unë, po s'qeshë unë,
e merr dreqi atë punë!*


*Ndërhyn vaji:- Eh, moj tapë,
shishja hesht,...kurse ti llap!*



BOJA DHE FURÇA

*Tek po lyhej një këpucë
i flet bojës zonja furçë:
"Hë, moj, si ma ke shëndetin?
Ç'bën, pse nxin realitetin!"*

*Boja furçën seç thumbon:
"Unë e nxij, ti e lustron!" ...*



NE SHAH

Mbreti mbretit i thotë prerë:

-Hidhi armët menjëherë!

Jeta jote kaq e pat;

nuk ke ç'bën, të zura mat!

Ia pret mbreti kundërshtar:

-Në betejë hodhe ushtarë,

fila, kuaj, mbretëreshë-

e në fund një thumb i ngjesh:

-Mos pandeh, më zure vetë?!

Sa për ty rroj njëmijë vjet!...

DOMATJA, BIZELJA DHE MISRI

*Te një arë me zarzavate
ngriti zërin një domate:
-Moj bizele, më vjen keq,
shumë po vuan, shumë po heq!
Sa mezi qëndron më gjunjë;
mbahu, mbahu pra, tek unë!*

*Por nga ara përkarshi
ia pret misri:-Ta mbash ti!?
Moj domate, kështu ç'flet!
Po... me shkop a s'mbahesh vetë!?!...*

BUFI, KRIMBI I MENDAFSHIT DHE BLETA

*Bufi sytë lëviz
edhe merr vendim:
Krimbin shpejt ta nisë
për specializim.*

*Përse do të shkojë
krimbi ynë jashtë?
...Do të marrë përvojë
për hoje, për mjaltë (!)*

*Krimbi niset sot...
Bletë, moj më qafsh:
S'dihet shkon ti mot
mbase për...mëndafsh!...*

ÇANTE E THES

Dikush mbrëmë në repart
fët e fët mbushi një çantë.

Syri tha: -Ç' më duhet mua,
unë e pashë, le të flasë gjuha!

Gjuha tha: -Ç'të them e gjora,
le ta kapë, ta mbërthejë dora!

Dora tha: -Iku me vrap,
ta ndjekë këmba e ta kapë!

Kape ti, jo, kape vetë!
U bë puna me stafetë.

Ai sot që në mëngjes
s'kish më çantë, kishte...thes...

IRIQI DHE MIU

*Një ditë më të gdhirë
iriqin pa një mi:*

*-Popo, ç'gjë e pështirë
s'u shihka dot me sy!*

*-Se kush është i pështirë,-
iriqi gjambat çon,-
a s'do të ish më mirë
të tjerët le ta thonë!?*

Dhe shtoi me finesë:

*-S'i ke në rregull trutë,
ndërsa unë rroj në vesë,
ti rron, o mi, në...*

DORA DHE KEMBA

*Qahej dora:-Ç'm'u desh mua,
të bëj nder e të jap hua!*

*Po ti, këmbë,ç'më rri, ç'pret;
mos pandeh se të vjen vetë!?*

*Ia kthen këmba:-Dreq o punë,
ti e jep, e... ta marr unë!*



MAÇI DHE MIU

*Kur pa maçin... vetëtimë
një miush u fsheh në vrimë.
"Mjau, mjau" bot e bot
mjauillinte maçi kot.
Prit e prit, e prit të dalë.
Miu s'bëhej hiç i gjallë.*

*Më pas maçi thur një plan:
nis të bëjë: "Ham,ham,ham!"*

*Tha miushi:-Eh, ky qen
ndonjë dhelpër po ndërren!
Nxori kokën për të parë,
por aty maçi kusar
shpejt e kapi:-Hiç mos luaj!
S'ha dot bukë pa gjuhë të huaj...*

KOPRACI NE DYQAN

Shkon kopraci në dyqan:

-Keni varëse?

-Posi kam!

Merre, kjo tetë lekë kushton.

Eshtë e mirë s'e shikon!

Dhe kopraci:-Më lirë s'ka?

-Katër lekshë, mor vëlla!

Dy lekë bën ajo atje.

-Po më lirë, më lirë s'ke?

-Kam, posi!-shitësi i thotë:-

Urdhëro e merr një...gozhdë!...

KERRIÇI DHE BILBILI

**Një kërraç pa zbardhur mirë
zu të pallë gjithë dëshirë...**

**Vajti ora dymbëdhjetë,
ja, kërraçi prapë pëllet...**

**Erdhi mbrëmja: "Ia, ia..."
Një bilbil u hodh, i tha:**

**-Nuk e di si shkon me shkollë,
por me ç'shoh, qënke i hollë!**

**Alfabeti, mor vëlla,
s'ka veç shkronjat "I" e "A"!...**

TENXHERJA DHE SOBA

*Dhe tenxherja si përherë
nisi që të bëjë poterë:
-Eh, ç' sekrete mbaj unë brenda,
askujt nuk ia pret mendja!*

*I tha soba: -Se ç'mban ti,
kjo garuzhda mirë e di.
Pastaj luga ia thotë pjatës,
pjata mishit e sallatës...
Brenda orës, moj mikeshë,
tërë kuzhina e merr vesh...*

MOSMIRENJOHJE

Në dyqanin e zdrukthtarit
një çekiç i tha sqeparit:
-More, prit, ku të kam parë,
mos e ke emrin hanxhar?

Ia pret lima:-Më mirë hiç,
se sa shok me një çekiç!
Ti i gdhende bisht të ri,
ai emrin nuk të di!...





THANA DHE SHALQIRI

*Te një arë rrinin pranë
një shalqi edhe një thanë.
-Pa vështromë, shalqi pak,
jam a s'jam e kuqe flakë?
Jo si ti ngjyrë jeshil,
si të jesh bar a tërfil!*

*Dhe shalqiri:-Do bësh mirë
të mos mburresh moj thartirë!
Që të dukem s'ma ka ënda,
unë të kuqen e kam brenda!*

VETEFRYRJE

*Kur pa demin te një stallë,
iu ul miza mu në ballë:*

*-Jo veç ti, o dem, - i tha,
por dhe unë bëhem ka!...*



KALI DHE MIZA

**Udhës po shkonte një kalë.
Një mizë kish hipur në shalë...
Si kaluan te një urë,
miza nis veten ta mburrë:**

**-E, o kalë, a e pe
kur mbi urë kaluam ne?
U trondit, mirë që s'ra;
Do ish bërë ndonjë hata!...**

**I thotë kali tej në kthesë:
-Duket unë qeshë pengesë.
Po të shkoje vetëm ti,
do kish rënë, hi, hi, hi!**

ANKESA E DERRIT


**Elefantin pa një ditë
edhe zbrazi bateritë:**

-Eh, hiletë s'kanë fund!

Shihni, shihni, shihni ç'hundë!

Këta njerëz janë çudi:


Hundëderr thonë përsëri!...



DORA, MASHA E THENGJILLI

*Dora mashën zë nga veshi
e pastaj prushin përsheshi.*

*Një thëngjill nxori shkëndija:
-Ja që iku burrëria.
Pse fut mashën, moj e shkretë;
Po ta mbajti, më zër vetë!...*



PERMBAJTJA

Një thënie e re	...3
Kush e hëngri mjaltin?	...4
Syri dhe veshi	.. 5
Syri, veshi, hunda	...6
Kali e dhelpira	. . 7
Iriqi dhe kërmilli	.. 8
Breshka dhe gomari	...9
Tenxherja dhe soba	...10
Mosmirënjohje	...11
Pellgu dhe bora	...12
Gjuha llafazane	...13
Mushka dhe gomari	...14
Tapja dhe shishja me vaj	...15
Boja dhe furça	...16
Në shah	...17

Domatja, bizelja dhe misri..	18
Bufi, krimbi i mëndafshit dhe bleta	...19
Çantë e thes	...20
Irlqi dhe mlu	...21
Dora dhe këmba	...22
Maçi dhe mlu	...23
Kopraci në dyqan	...24
Kërraçi dhe bilbili	...25
Thana dhe shalqiri	...26
Vetëfryrje	...27
Kali dhe miza	...28
Ankesa e dërrit	...29
Dora, masha e thëngjilli	...30



LIBRA TE AUTORIT

Në verë dhe në dimër
Veci, Veci, mburraveci

Zemërqeshur

Vogëlushi ynë Tan

Në kopshtin zoologjik

Lepuri që bën shaka

Tosi me fustan

Kush e hëngri mjaltin?

Gjelkokoshi zgjon derrkucin

Bilbili dhe gjinkalla

Tori piktori

Fabula

58 l.



